



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:131845

Datë: 12.02.2025

Numri i dokumentit: 06841603

P.2023:171424

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, në çështjen penale ndaj të pandehurit U. Rr, i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.737/23 e datës 09.08.2023, më datë 12.02.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET marrëveshja me Nr. Ndërmjetësimi 64/24 e datës 07.11.2024 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimi e kësaj gjykate në Kaçanik në mes të pandehurit U. (Xh...) Rr dhe palës së dëmtuar S. V.

II.HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.737/23 e datës 09.08.2023 dhe ndërpritet procedura penale ndaj të pandehurit U. Rr., i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, pasi që lënda është zgjidhur me marrëveshje në mes të palëve përmes procedurës së ndërmjetësimi.

III. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.737/23 e datës 09.08.2023 ndaj të pandehurit U. Rr, i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Gjykata, e ka referuar lëndën në ndërmjetësim me kërkesën dhe pëlqimin e palëve, si rrjedhojë e kësaj gjykata e ka aprovuar marrëveshjen që është bazuar në nenin 17 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin Nr. 06/L-009 për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform numrit referues të ndërmjetësimit 64/24 e datës 07.11.2024

Lidhur me shpenzimet procedurale është vendosur konform dispozitës së nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë si dhe duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.2023:171424 të datës 12.02.2025

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.